

Në bazë të nenit 99 paragrafi (8) të Ligjit për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/06, 35/08, 150/10, 83/18, 198/18) dhe (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 96/19), kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

RREGULLORE PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT INFORMATIK GJYQËSOR NË GJYKATAT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

(1) Me këtë Rregullore rregullohen mënyra e funksionimit të sistemit informatik në gjykatat në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe mënyrën e shfrytëzimit të teknologjisë informatike për menaxhim me sistemin e automatizuar kompjuterik për udhëheqjen me lëndët gjyqësore.

Neni 2

(1) Rregullat për mënyrën e funksionimit të sistemit informatik zbatohen në gjykatat themelore dhe të apelit, në Gjykatën Administrative, në Gjykatën e Lartë Administrative dhe në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

II. Sistemi informatik gjyqësor

Neni 3

(1) Sistemi informatik gjyqësor është pjesë përbërëse e Qendrës për teknologji informatike të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe njësive për informatikë në gjykatat në Republikën e Maqedonisë së Veriut si njësi të veçanta organizative.

Neni 4

(1) Qendra për teknologji informatike e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut është kompetente për menaxhimin teknik me sistemin e automatizuar kompjuterik për udhëheqjen me lëndët gjyqësore, portalin gjyqësor dhe bazat e të dhënave që burojnë nga puna e gjykatave.

Neni 5

(1) Qendra për informatikë e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht shërbimet, organizon mbështetjen informatike të punës së gjykatës, kujdeset për infrastrukturën informatike, aplikacionet dhe bazat e të dhënave që i menaxhon dhe shfrytëzon gjykata, i ndjek dhe i zbaton proceset e reja teknologjike, kujdeset për mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave dhe të tërë sistemit, në mënyrë sistematike i arkivon dhe në mënyrë adekuate i ruan të dhënat, i trajnon gjyqtarët dhe të punësuarit në shërbimin gjyqësor dhe iu jep ndihmë profesionale gjykatave më të ulëta.

Teknologjia informatike - komunikuese (TIK)

Neni 6

(1) Teknologjinë informatike – komunikuese (TIK) të gjykatës e përbëjnë serverë, kompjuterë, printerë, skanerë, sistemet për magazinimin e të dhënave, gjeneratorë dhe pajisje të furnizimit me energji të pandërprerë, pajisje për komunikim dhe infrastrukturë, mbrojtjen e rrjetit të barrierës (Firewall), programet dhe pajisjet e sistemit, aplikacionet standarde, programet e shfrytëzuesit, programi për udhëheqjen me qarkullimin e lëndëve gjyqësore (AKMIS), programi për punën materiale dhe financiare (ABMS), të dhënat që futen në sistemin, përditësohen, rruhen dhe mbrohen.

Neni 7

(1) Pajisje harduerike – softuerike nga fusha e TIK – ut siguron funksionimin papengesë të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjykatave dhe Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Në sistem – sallën e sistemit informatik të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut është vendosur pajisja harduerike – softuerike nga fusha e TIK – ut, janë përcaktuar bazat e centralizuara së të dhënave, funksionalitetet e centralizuara, ndërveprimi, ndërlidhja, organizëm strehues i ueb – portaleve gjyqësore të dedikuara për punën papengesë në të gjitha gjykatat.

Neni 8

(1) Sistem – salla e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut funksionon në përputhje me standardet e kushteve të përcaktuara të sigurimit hapësinor, klimatik, dhe energjetik.

(2) Sistem – salla e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut përfshin sipërfaqen prej mbi 50 m², nuk ka dritare, me dysheme të ndarë kundër statike, kablllo të pavarura për energji, sistemi profesional për freskim, derë metalike, hyrje e kontrolluar me kartelë magnetike vetëm për të punësuarit nëpunës gjyqësorë në Qendrën e Informatikës dhe për policinë gjyqësore në raste të situatave të paparashikuara.

Neni 9

(1) Në sistem – sallat e shërbimeve për informatikë të gjykatave është vendosur pajisja harduerike – softuerike nga fusha e TIK – ut, dedikuar për funksionimin papengesë të gjykatës.

(2) Gjykatat i sigurojnë standardet e përcaktuara për sigurimin e kushteve hapësinore, klimatike dhe energjetike të sistem – sallave në kompetencën e tyre.

Neni 10

(1) Gjykatat vendosin dhe zbatojnë masa për sigurinë fizike të hapësirave në të cilat është vendosur tërë pajisja e TIK – ut:

1. Sistem – salla;
2. Hapësira për gjeneratorë, UPS;
3. LAN (pajisja me rrjet aktiv dhe pasiv);
4. Raftë të rrjetit (RACK) të montuara në ndërtesat e gjykatave;
5. Hapësirat punuese të shfrytëzuesve të sistemeve të TIK-ut.

Neni 11

(1) Qasja fizike në sistem-sallën e gjykatave mund t'iu mundësohet vetëm nëpunësve të punësuar gjyqësor në Qendrën e informatikës dhe njësinë për informatikë që kanë autorizim nga kryetari i gjykatës.

(2) Sipas nevojës, qasja fizike në sistem-sallën dhe në hapësirat tjera ku është vendosur pajisja – TIK mund t'iu mundësohet personave juridik të punësuar të detyruar për mirëmbajtjen e TIK – sistemeve adekuate, me plotësimin paraprakisht të kushteve si në vazhdim:

- Personi duhet të jetë i evidentuar se është në vizitë zyrtare të gjykatës;
- Personi duhet të ketë deklaratë të nënshkruar për sekretin dhe mbrojtjen e përpunimit së të dhënave personale për personat e jashtëm;
- Personi detyrimisht të shoqërohet dhe mbikëqyret nga një nëpunës i autorizuar gjyqësor për qasjen në hapësirat ku janë të vendosura TIK – sistemet.

Masat për monitorimin dhe mbrojtjen e të dhënave

Neni 12

(1) Gjykatat vendosin dhe zbatojnë masa për monitorimin e pajisjeve harduerike – softuerike nga fusha e TIK – ut, të dedikuar për funksionimin papengesë të gjykatës:

1. Sistemet operative, programet dhe veglat e sistemit;
2. Struktura Active Directory;
3. Platforma e virtualizimit;
4. Sistemi për mbrojtjen e të dhënave;

5. Programi kundër bllokimit dhe kundër virusi;
6. Programet e shfrytëzimit;
7. Pajisje harduerike;
8. Pajisje komunikuese dhe infrastrukturë;
9. Pajisje për mbrojtje (Firewall) dhe të tjera.

Neni 13

(1) Gjykatat vendosin dhe zbatojnë masa për mbrojtjen e të dhënave që të pengohet humbja ose shkatërrimi i tyre. Për këtë qëllim gjykatat bëjnë incizimin e të dhënave të futura në sistemet informatike që rruhen një periudhë të caktuar kohore TIK - pajisjen në gjykatë.

(2) Për mbrojtjen shtesë, prej tyre bëhen kopje të TIK - pajisjes së vendosur në Qendrën e informatikës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut që rruhen për një periudhë të caktuar kohore.

Planifikimi, mirëmbajtja ose restaurimi i sistemeve - TIK

Neni 14

(1) Pas skadimit të periudhës së garancisë ose ciklit të përdorimit të mallrave të – TIK dhe shërbimet e unifikuara që janë siguruar në kuadër të projekteve – TIK, në të cilat ka marrë pjesë Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ajo bën planifikimin dhe vlerësimin e vlerës së nevojave të planifikuara për mirëmbajtjen apo restaurimin e tyre, që dedikohen për gjykatat dhe Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Gjatë planifikimit dhe vlerësimit bëhet llogaritja e vazhdueshme e funksionaliteteve veç më të vendosura:

1. Unifikimi i mallrave dhe shërbimeve;
2. Bazat e centralizuara së të dhënave;
3. Funksionalitetet e centralizuara;
4. Ndërveprimi;
5. Ndërlidhja;
6. Strehimi i ueb – portaleve gjyqësore.

Neni 15

(1) Pas miratimit paraprak nga Këshilli i buxhetit gjyqësor në lidhje me mjetet financiare që nevojiten për mirëmbajtjen ose restaurimin e sistemeve – TIK, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut realizon procedurë për furnizimin publik.

(2) Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes rrugës elektronike, përkatësisht përmes postës elektronike, i njofton gjykatat për mirëmbajtjen e siguruar të mallrave dhe shërbimeve me kohëzgjatjen e caktuar të mirëmbajtjes, faturat elektronike për mbështetjen e shfrytëzuesve, procedurën për paraqitjen e problemeve të shfaqura dhe kërkesën për ndihmë.

Neni 16

(1) Gjykatat bëjnë planifikimin dhe zbatojnë procedurën për mirëmbajtjen ose restaurimin e pajisjeve/shërbimin e – TIK që nuk përfshihet me mirëmbajtjen e marrë veshur të zbatuar nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut apo një gjykatë tjetër kompetente në përputhje me Vendimin e Këshillit të Buxhetit Gjyqësor.

Paraqitja e problemeve dhe kërkesa e ndihmës ose mbështetja

Neni 17

(1) Për procedurat që i realizon Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, komunikimin dhe të drejtuarit në personat juridik (kompanive), që janë të detyruar për mirëmbajtjen e TIK-sistemeve adekuate, në rastin kur paraqitet një problem, jo funksionalitet ose kërkohet intervenim, shërbim konsultues ose diçka tjetër në kuptim të sigurimit për funksionimin papengësë të sistemit, realizohen përmes postës elektronike ose me sistem – të tiketave të vendosur.

(2) Nëpunësit gjyqësor të punësuar në qendrat/njësitë për teknologji informatike në gjykatat dhe në Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dorëzojnë lajmërim/kërkesë me përshkrim të shkurtër të problemit në llogarinë e e-mail për mbështetjen e shfrytëzuesit të kompanisë së detyruar për mirëmbajtjen dhe kopjen e (Carbon copy) drejtuar llogarisë së e-mailit të Qendrës së informatikës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut (itcentar@vsrm.mk).

(3) Aktivitetet e marra për shkarkimin e problemit me postë elektronike në mënyrë kthyesë i dërgohen nëpunësit gjyqësor në Qendrën apo Njësinë për teknologji informatike, që e ka përgatitur kërkesën/njoftimin, ndërsa në mënyrë elektronike, përkatësisht përmes postës elektronike dorëzohet një kopje edhe në Qendrën e informatikës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(4) Bashkëpunimi dhe koordinimi i Qendrës së informatikës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut me njësitë për informatikë të gjykatave dhe Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut realizohet në mënyrë elektronike, përkatësisht përmes postës elektronike.

Përditësimi i bazës së nomenklaturave qendrore

Neni 18

(1) Në Qendrën e informatikës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut qëndron baza e nomenklaturave qendrore, e dedikuar për punën papengësë të aplikimit për udhëheqjen automatike me lëndët gjyqësore të zbatuara në gjykatat.

(2) Baza e nomenklaturave qendrore përmban disa kategori të dhënash:

1. Kategori të dhënash të përgjithshme;

2. Persona (pjesëmarrës në lëndë gjyqësore);
3. Organizimi gjyqësor;
4. Përcaktimi i lëndëve;
5. Përcaktimi i bazave, akteve dhe vendimeve.

(3) Të dhënat që shtohen apo ndryshohen në bazën e nomenklaturave të centralizuara me inicimin e sinkronizimit nga ana e çdo gjykate barten në bazat lokale në të gjitha gjykatat.

(4) Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut emëron një person administrator të nomenklaturave të centralizuara që, në përputhje me Rregulloren gjyqësore, obligohet për futjen dhe përditësimin e të gjitha nomenklaturave të centralizuara dhe për komunikimin dhe bashkëpunimin me të gjitha institucionet që i përgjithësojnë dhe me përditësim i mirëmbajnë të dhënat e duhura për punën papengesë së të gjitha gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Përditësimi i nomenklaturave të përgjithshme

Neni 19

(1) Në nomenklaturat e përgjithshme përfshihen të dhënat për shtete, komuna, vendbanime, veprimtari, lloje të pronësisë, kombësia, arsimimi, profesione, llojet e taksave.

(2) Të dhënat në nomenklaturat e përgjithshme janë marrë nga institucionet që janë kompetente për udhëheqjen me regjistrin adekuat.

(3) Në qoftë se paraqitet nevoja për përditësimin e tyre, bëhet bashkëpunimi adekuat me institucionet kompetente ku përditësohen nomenklaturat e përgjithshme.

Përditësimi i kategorisë “Persona”

Neni 20

(1) Në kategorinë “Persona” përfshihen të dhënat e personave që janë pjesëmarrës në lëndët gjyqësore, përkatësisht avokatë, noterë, përmbarues, ndërmjetësues dhe drejtorë të falimentimit.

(2) Për futjen fillestare të një avokati, noteri, përmbaruesi, ndërmjetësuesi ose për ndryshimin e një të dhëne veç më të futur në nomenklaturat qendrore adekuate duhet të dorëzohen:

- Kërkesë me shkrim në njësinë pranuese të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose përmes postës elektronike drejtuar info@vsrm.mk, itcentar@vsrm.mk.

- Aktvendim për regjistrim në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut apo gjendjen aktuale nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut për konfirmimin e statusit të personit.

(3) Të dhënat për drejtorët e falimentimit përditësohen automatikisht përmes ndërlidhjes së vendosur në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut me Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Përditësimi i kategorisë “Organizimi gjyqësor”

Neni 21

(1) Në kategorinë “Organizimi gjyqësor” përfshihen të dhënat për gjyqtarët, gjykatat dhe llojet e proceseve.

(2) Të dhënat për gjykatat dhe gjyqtarët udhëhiqen dhe përditësohen në Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut prej ku bëhet sinkronizimi në nomenklaturat qendrore dhe nomenklaturat lokale në çdo gjykatë përkatëse.

Përditësimi i nomenklaturave lidhur me punën gjyqësore

Neni 22

(1) Nomenklaturat lidhur me punën gjyqësore janë: ligje, nenet e ligjeve, llojet e lëndëve, regjistra, llojet e bazave juridike dhe bazat juridike, akte, vendime dhe të ngjashme.

(2) Kërkesat për futjen e vlerave të reja apo ndryshimi i vlerave ekzistuese në këtë kategori të nomenklaturave i dorëzohen Trupit punues për standardizimin e procedurave në gjykatat që përgjigjet para kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në formë të shkruar me plotësimin e një formulari:

- Kërkesa drejtuar Trupit punues për ndryshimin apo paraqitjen e një ligji të ri, llojet e bazave, bazat dhe nenet.

- Kërkesa drejtuar Trupit punues për hapjen e një regjistri të ri në nomenklaturat qendrore.

(3) Në përputhje me procedurat e punës së Trupit punues, kërkesa duhet të nënshkruhet nga kryetari i gjykatës apo personi përgjegjës i emëruar nga kryetari i gjykatës që e parashtron kërkesën, propozimin apo çështjen.

Privilegjet e centralizuara të shfrytëzuesve për punën me sistemet e centralizuara në sistemin gjyqësor

Neni 23

(1) Në Qendrën e informatikës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë vendosur, rruhen dhe mbrohen bazat e centralizuara për nevojat e Sistemit për dorëzimin elektronik të dokumenteve gjyqësore, Sistemin e evidencës dënuese, si dhe bazën e vendimeve të publikuara gjyqësore në ueb – portalet, ndërsa gjykatat fusin dhe përditësojnë të dhëna në to.

(2) Në Qendrën e informatikës bëhet strehimi i ueb – portaleve gjyqësore. Për këtë qëllim llogaritë e shfrytëzuesve, si dhe të drejtat e shfrytëzuesve dhe privilegjet e nëpunësve të autorizuar gjyqësor që janë të punësuar në gjykatat dhe në Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut definohej të centralizuara nga nëpunësit gjyqësor nga Qendra e informatikës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Privilegjet e shfrytëzuesit për sistemin e dorëzimit elektronik të dokumenteve gjyqësore

Neni 24

(1) Kryetari i gjykatës miraton vendim me të cilin autorizohet një person – operator për aprovimin e regjistrimit të shfrytëzuesve dhe administrimin e kutive postare elektronike të shfrytëzuesve të paraqitur në sistem.

(2) Vendimi dorëzohet me postë ose në mënyrë elektronike në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për procedim të mëtejshëm.

Pasi që nëpunësit gjyqësor nga Qendra e informatikës në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut do të krijojnë llogari të shfrytëzuesit për personat e autorizuar, përmes postës elektronike në adresën zyrtare të gjykatës dorëzojnë njoftim që i përfshin të dhënat e duhura për emrin e krijuar të përdoruesit dhe fjalëkalimin.

(3) Personat e autorizuar – operatorë nga gjykatat obligohen të bëjnë ndryshimin e fjalëkalimit gjatë lajmërimit në Sistemin për dorëzimin elektronik të dokumenteve gjyqësor.

Privilegjet e shfrytëzuesit për sistemin e evidencës dënuese

Neni 25

(1) Kryetari i gjykatës miraton vendim me të cilin autorizohen një ose disa nëpunës gjyqësorë për punën me bazën e të dhënave nga evidenca dënuese (futja, përditësimi i të dhënave dhe/apo lëshimi i certifikatave (vërtetimeve) nga evidenca dënuese).

(2) Vendimi nga paragrafi (1) i këtij neni dorëzohet me postë ose në mënyrë elektronike në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për procedim të mëtejshëm.

(3) Pas krijimit të llogarisë së shfrytëzuesit për personat e autorizuar, nëpunësit gjyqësor nga Qendra e informatikës përmes postës elektronike dorëzojnë njoftim në adresën zyrtare të gjykatës që i përfshin të dhënat e duhura për krijimin e emrit të shfrytëzuesit dhe fjalëkalimin.

(4) Nëpunësit e autorizuar gjyqësor detyrueshëm bëjnë ndryshimin e fjalëkalimit gjatë lajmërimit të parë në Sistemin e evidencës dënuese.

Privilegjet e shfrytëzuesit për ueb – portalet e gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Neni 26

(1) Kryetari i gjykatës dhe kryetari i Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratojnë vendim me të cilin autorizohen një ose disa nëpunës gjyqësor për punën me ueb – portalin. Vendimi, dorëzohet përmes postës ose në mënyrë elektronike, në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për procedim të mëtejme.

(2) Pasi që nëpunësit gjyqësor nga Qendra e informatikës do t'iu ndajnë të drejta përdorimi dhe privilegje në llogaritë ekzistuese të personave të autorizuar, përmes postës elektronike në adresën zyrtare të gjykatës që e ka parashtruar kërkesën dërgojnë njoftim për vendimin e zbatuar.

III. Udhëheqja me lëndët

Neni 27

(1) Në gjykatat përdoret sistemi i automatizuar kompjuterik për udhëheqjen me lëndët gjyqësore si një sistemi i vetëm për udhëheqjen e automatizuar me lëndët gjyqësore.

(2) Udhëheqja e automatizuar me lëndët gjyqësore paraqet marrjen e veprimeve që detyrimisht regjistrohen përmes sistemit të automatizuar kompjuterik për udhëheqjen me lëndët gjyqësore, nga dita e pranimin të shkresave në gjykatën deri në ditën e përfundimit të plotfuqishëm dhe arkivimit të lëndëve në përputhje me ligjin.

Neni 28

(1) Sistemi i automatizuar detyrimisht shfrytëzohet gjatë udhëheqjes me qarkullimin e lëndëve në gjykatat dhe nuk lejon lëvizje të mëtejshme të lëndës pa të dhëna të futura plotësisht.

(2) Sistemi i automatizuar kompjuterik për udhëheqjen me lëndët gjyqësore në gjykatat mundëson, përmes të komunikimit elektronik, këmbimin e të dhënave adekuate ndërmjet gjykatave, si dhe gjykatave midis organeve tjera juridike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Neni 29

(1) Lëndët që vijnë në gjykatën për vendimmarrje iu shpërndahen gjyqtarëve në mënyrë elektronike me shpërndarjen automatike përmes sistemit të automatizuar kompjuterik për udhëheqjen me lëndët gjyqësore në përputhje me ligjin.

Sistemi i automatizuar për udhëheqjen me lëndët gjyqësore

Neni 30

(1) Sistemi i automatizuar kompjuterik për udhëheqjen me lëndët gjyqësore përbëhet nga aplikacionet standarde, pajisjet kompjuterike dhe telekomunikuese dhe infrastruktura, softueri sistemor dhe veglat dhe të gjitha të dhënat e futura dhe të magazinuara nga të gjitha llojet e regjistrave në gjykatat.

(2) Sistemi i automatizuar kompjuterik për udhëheqjen me lëndët gjyqësore është i vetmi dhe gjithëpërfshirës, përkatësisht çdo gjykatë përdor të njëjtin version me të cilin bëhet procesi i të gjitha llojeve të lëndëve gjyqësore.

(3) Sistemi i automatizuar kompjuterik për udhëheqjen me lëndët gjyqësore në gjykatat mundëson, që përmes komunikimit elektronik, këmbimin e të dhënave adekuate midis gjykatave dhe Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(4) Sistemi i automatizuar kompjuterik për udhëheqjen me lëndët gjyqësore është i lidhur dhe në mënyrë elektronike këmben të dhëna adekuate me:

1. Sistemin e drejtorëve të falimentimit;
2. Sistemin e Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
3. Sistemin e "Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut";
4. Sistemin e ndërveprimit nën kompetencën e Ministrisë së Shoqërisë informatike dhe Administratës.

(5) Sistemi i automatizuar kompjuterik për udhëheqjen me lëndët gjyqësore mund të lidhet edhe me sistemet tjera për të cilat konsideron se janë të domosdoshme.

Neni 31

(1) Të gjitha të dhënat për lëndët në gjykatat, si dhe veprimet e marra në procedurat udhëhiqen në formë elektronike, me shfrytëzimin e sistemit të automatizuar kompjuterik për udhëheqjen me lëndët gjyqësore në gjykatat.

(2) Sistemi i automatizuar kompjuterik për udhëheqjen me lëndët gjyqësore në gjykatat mundëson që të dhënat e futura të lëndëve të tregohen të organizuara në regjistrat elektronik, librat e evidencës.

(3) Duke shfrytëzuar sistemin e automatizuar kompjuterik për udhëheqjen me lëndët gjyqësore në gjykatat, gjykatat i fusin lëndët e tyre me shënim elektronik në regjistrat elektronik adekuat, librat e evidencës.

(4) Sistemi i automatizuar kompjuterik për udhëheqjen me lëndët gjyqësore në gjykatat mundëson klasifikimin e lëndëve gjyqësore në lloje të ndryshme të regjistrave elektronik, nën regjistrat, librat e evidencës varësisht nga organizimi i gjykatës, llojet e lëndëve dhe numrin e lëndëve.

(5) Çdo gjykatë siguron ekzistimin e kopjeve rezerve nga të dhënat e tyre elektronike, në përputhje me procedurën e brendshme për mënyrën e bërjes së kopjes së sigurt së të dhënave dhe mënyrën e ruajtjes dhe sigurimin e kopjeve elektronike rezerve në përputhje me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 32

(1) Shfrytëzimi i teknologjisë informatike është i qasur për të gjithë gjyqtarët dhe nëpunësit gjyqësor që marrin pjesë drejtpërdrejtë në procedimin e lëndëve gjyqësore.

(2) Shfrytëzuesit e sistemit të automatizuar kompjuterik për udhëheqjen me lëndët gjyqësore në gjykatat, sipas rolit funksional në procedimin, kategorizohen në grupe shfrytëzuese.

(3) Administratori gjyqësor, përkatësisht kryetari i gjykatës, ku nuk ka administrator gjyqësor, përgatit listë të gjyqtarëve dhe nëpunësve gjyqësor me të cilën i sistemon në grupe shfrytëzuese, në mënyrë të duhur për rolin e tyre në procedimin e lëndëve.

(4) Lista e shfrytëzuesve nga gjykata të ndarë sipas grupeve të shfrytëzuesve nga paragrafi (3) të këtij neni i dorëzohet nëpunësit gjyqësor përgjegjës për teknologjinë informatike.

(5) Lista nga paragrafi (3) i këtij neni përfshin:

1. Emrin dhe mbiemrin;
2. Profesionin / vendin e punës;
3. Grupin adekuat të shfrytëzuesit;
4. Llojet e regjistrave.

(6) Nëpunësi gjyqësor përgjegjës për TIK në gjykatë, në bazë të listës nga paragrafi (3) të këtij neni, secilit nga shfrytëzuesit i mundëson qasje dhe punë me sistemin e automatizuar kompjuterik për udhëheqjen me lëndët gjyqësore në gjykatat dhe i njofton për mënyrën e përdorimit të teknologjisë informatike.

(7) Nëpunësi gjyqësor përgjegjës për TIK në gjykatën në fillim ia ndan dhe e njofton çdo shfrytëzues për kombinimin e vetëm me emër të shfrytëzuesit dhe fjalëkalimin (kombinimin qasës).

(8) Shfrytëzuesi në fillim gjatë qasjes në sistemin, në përputhje me dokumentin e sigurimit të vendosur, detyrimisht e ndryshon fjalëkalimin e caktuar të qasur, krijon kombinimi e tij qasës që e din vetëm ai dhe është përgjegjës për çdo aktivitet me shfrytëzimin e tij.

(9) Për shkak të sigurimit të sistemit në çdo gjykatë është vendosur dokument sigurimi dhe, në përputhje me të, fjalëkalimi ka të paktën 8 alfa – karaktere numerike nga të cilat minimum një shkronjë të madhe, shkronja të vogla, numra apo shenja speciale. Çdo shfrytëzues në një periudhë kohore që nuk është më e gjatë se tre muaj, në përputhje me dokumentin e sigurimit të vendosur, e ndryshon fjalëkalimin përmes procedurës adekuate elektronike.

(10) Zbatimi i paragrafëve (8) dhe (9) të këtij neni sigurohet në përputhje me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale.

Mënyra dhe procedura për udhëheqjen me lëndët

Neni 33

(1) Pas pranimit të aktit fillestar në sportelin gjyqësor, nëpunësi i autorizuar gjyqësor i fut të dhënat nga ai në formë elektronike dhe formon lëndë gjyqësore.

(2) Lënda e formuar automatikisht shpërndahet sipas principit të zgjedhjes së rastësishme të një gjyqtari të caktuar, sipas kriterëve të përcaktuara nga Trupi punues për standardizimin e procedurave në gjykatat që përgjigjet para kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Gjatë shpërndarjes automatike çdo gjyqtar fiton numrin e barabartë të lëndëve.

(4) Pas dërgimit elektronik të lëndës te gjyqtari, ai/ajo në mënyrë elektronike e konfirmon pranimin e lëndës dhe e merr atë në punë.

Neni 34

(1) Në rastet e mungesës më të gjatë dhe përjashtimit të gjyqtarit në përputhje me ligjin bëhet rishpërndarja automatike e lëndëve.

Neni 35

- (1) Për çdo veprim të marrë deri në përfundimin e procedurës bëhet shënim elektronik.
- (2) Gjyqtari në afat të përcaktuar me ligj cakton seancë dhe nga ai nëpunësi i autorizuar gjyqësor e vendos në kalendarin e gjykimeve.
- (3) Udhëheqja elektronike e kalendarit është e detyrueshme për qasjen e të dhënave të palëve, përfaqësuesve të tyre dhe personat tjerë të interesuar.

Член 36

- (1) Pas përfundimit të procedurës lënda elektronike dorëzohet në sportelin gjyqësor me udhëzimin për procedim të mëtejshëm.
- (2) Pas verifikimit të vendimit nga gjyqtari dhe dërgimit të tij, në shënimin elektronik nuk bëhen kurrfarë korrigjime apo ndryshime.

Neni 37

- (1) Të gjitha veprimet deri në përfundimin e plotfuqishëm të procedurës për lëndën, si dhe procedura për mjete të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike evidentohen në mënyrë elektronike.
- (2) Nëpunësi i autorizuar gjyqësor në sportelin gjyqësor detyrimisht në mënyrë elektronike i evidenton datën e plotfuqishmërisë dhe datën e përmbartimit të vendimit.
- (3) Pas përfundimit të procedurës lënda arkivohet në përputhje me Ligjin për material arkivor.

Mbrojtja e të dhënave personale

Neni 38

- (1) Në realizimin e punëve të administratës gjyqësore, punën administrative dhe udhëheqjen e regjistrave gjyqësor, regjistrat dhe librat tjerë ndihmës, gjykatat përdorin teknologji informatike për përpunimin automatik së të dhënave.

Neni 39

(1) Kryetari i gjykatës është kompetent për sigurimin e kushteve teknike, organizative dhe të kuadrove për funksionimin e teknologjisë informatike të gjykatës për futjen e të dhënave në mënyrë të saktë dhe me përditësim, për zbatimin e masave të shënuara për sigurimin e rruajtjes dhe mbrojtjen e të dhënave lidhur me shfrytëzimin e teknologjisë informatike të gjykatës.

Neni 40

(1) Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Su-03.nr.709/23
18.01.2024

**KRYETARJA E GJYKATËS SUPREME TË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

Besa Ademi d.v.